

7 shkurt 2022



Banka e Shqipërisë
Departamenti i Politikës Monetare




Komisioni Evropian¹

Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe të Konsumatorit

Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE) rezultoi 107.2, duke shënuar rënie të lehtë, prej 1.7 pikësh në muajin janar. Megjithatë, ai mbetet rreth 7 pikë mbi mesataren afatgjatë (Grafik 1). Rënia e TNE-së u përcaktua kryesisht nga rënia e besimit në sektorin e industrisë dhe shërbimeve dhe, në një shkallë më të vogël, nga rënia e besimit konsumator. Besimi në sektorët e ndërtimit dhe në atë të tregtisë u përmirësuan në muajin janar (Grafik 2).

Grafik 1. Treguesi i ndjesisë ekonomike (TNE)




Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Treguesi i besimit të industrisë (TBI) shënoi rënie me 3.8 pikë përqindje krahasuar me muajin e kaluar, i ndikuar nga ecuria në rënie e balancës së *prodhimit* dhe *kontratave porositëse*. Ndërkohë, pritjet e bizneseve për *prodhimin*, *punësimin* dhe për *çmimet* në të ardhmen janë në rritje në muajin janar (Tabelë 2, sektori i industrisë).

¹ Vrojtimet e besimit bashkë-financohen nga Bashkimi Evropian dhe Banka e Shqipërisë. Duke filluar nga muaji maj i vitit 2016, ato kaluan në programin e harmonizimit të Komisionit Evropian. Prej muajit qershor 2021 publikimi i analizave dhe të dhënave nga vrojtimet e publikohen me frekuencë mujore.

Treguesi i besimit në ndërtim (TBN) iu rikthye përmirësimit në muajin janar, duke shënuar një vlerë 3.1 pikë përqindje më të lartë se sa një muaj më parë. Ky zhvillim u ndikua si nga përmirësimi i balancës për *aktivitetin ndërtues* ashtu edhe nga treguesi për *kontratat porositëse*. Rritje regjistruan dhe pritjet për nivelin e *punësimit*, ndërkohë që ato për *çmimet* regjistruan rënie, pas rritjeve të njëpasnjëshme të tre muajve të fundit (Tabelë 2, sektori i ndërtimit).

Grafik 2. Treguesit e besimit sipas sektorëve*.



Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.


Shënim: *Grafiku paraqet vlera të standardizuara, për të korrigjuar ndryshimet ndërmjet mesatareve dhe devijimeve standarde të treguesve të besimit përkatës.

Treguesi i besimit në shërbime (TBSh) shënoi rënie me 4.2 pikë përqindje në muajin janar, ndikuar nga performanca më e dobët e komponentëve të lidhur me *ecurinë e biznesit* dhe me *kërkesën* për shërbime. Në linjë me këta tregues, bizneset vlerësojnë situatën aktuale të *punësimit* në rënie. Ndërkohë, pritjet e tyre për *ecurinë* e *punësimit* dhe atë të *çmimeve* në të ardhmen u paraqitën me rritje (Tabelë 2, sektori i shërbimeve).

Treguesi i besimit në tregti (TBT) u rrit me 3.4 pikë përqindje në muajin janar, i ndikuar kryesisht nga vlerësimet më të mira të bizneseve për *ecurinë aktuale të biznesit* të tyre (Tabelë 2, sektori i tregtisë). Ndërkohë, pritjet për *ecurinë* e *biznesit* në muajt e ardhshëm, për *porositë* dhe *punësimin* janë në përkeqësim në krahasim me ato të muajit të kaluar.


Treguesi i besimit konsumator (TBK) shënoi rënie me 0.7 pikë përqindje në muajin janar. Kjo rënie përkeqësoi pozicionin e tij krahasuar edhe me mesataren e vet afatgjatë (Grafik 2). Treguesi pasqyroi vlerësimin më negativ të konsumatorëve lidhur me *blerjet në shuma të mëdha* si dhe pritjet për *situatën e tyre financiare* në të ardhmen. Nga ana tjetër, pritjet për *situatën e përgjithshme ekonomike* në vend kanë ardhur në përmirësim në muajin janar (Tabelë 2, konsumatorët).

Grafik 3. Situata e biznesit sipas sektorëve gjatë muajve të fundit.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për situatën e biznesit gjatë muajve të ardhshëm.




Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 4. Pritjet për papunësinë dhe çmimet e konsumatorëve për 12 muajt e ardhshëm.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Grafik 5. Blerjet në shumë të mëdha të konsumatorëve.



Burimi: Banka e Shqipërisë.

Tabelë 1. Treguesit e besimit sipas sektorëve*

	Vlerat			2021					2022	Situata aktuale	
	min	mes	max	Gusht	Shtator	Tetor	Nëntor	Dhjetor	Janar	Koniunkturale**	Strukture***
Industri	-59.9	-12.2	7.9	-7.9	-7.4	-1.7	-4.5	-3.1	-6.9	↓	+
Ndërtim	-57.4	-28.1	-7.8	-11.1	-17.5	-13.8	-7.8	-18.9	-15.9	↑	++
Shërbime	-46.8	5.1	27.2	22.0	17.9	22.6	22.9	27.2	23.1	↓	++
Tregti	-33.5	-2.5	18.4	6.1	6.4	5.9	5.6	8.5	11.9	↑	++
Konsumator	-40.8	-25.3	-16.5	-26.1	-25.1	-32.6	-31.8	-29.9	-30.6	↓	-

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

*) Treguesit janë llogaritur nga balanca të rregulluara për sezonalitet. Balancat minimale, mesatare dhe maksimale, janë të llogaritura duke filluar nga maj 2016.

**) Situata krahasuar me muajin e mëparshëm.

***) Situata për secilin tregues konsiderohet: shumë e kënaqshme (++), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e kënaqshme (+), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i lartë se mesatarja; e pakënaqshme (-), kur treguesi është më pak se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja; dhe shumë e pakënaqshme (--), kur treguesi është më shumë se 1 devijim standard më i ulët se mesatarja.

Tabelë 2. Balancat kryesore të sektorëve të ekonomisë (në pikë përqindje).

	2021								2022
	Maj	Qersh.	Korr	Gusht	Shtat	Tetor	Nëntor	Dhjet.	Janar
INDUSTRIA									
Prodhimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBI-së)	16.8	14.3	23.4	23.5	17.2	23.5	17.4	21.9	20.5
Kontratat porositëse (pyetja 2, komponent i TBI-së)	-19.2	-18.6	-18.5	-17.8	-17.9	-11.2	-14.5	-11.5	-12.7
Kontratat porositëse nga eksportet (pyetja 3, komponent i TBI-së)	-26.6	-32.9	-26.9	-29.3	-21.5	-17.3	-16.2	-19.8	-28.6
Inventari i produkteve të përfunduara (pyetja 4)	1.0	-3.4	-5.2	-5.9	-4.9	-6.0	-7.4	-3.9	-1.3
Prodhimi pritje (pyetja 5)	27.6	32.2	37.4	33.1	36.3	34.5	37.5	33.5	35.0
Çmimet e produkteve pritje (pyetja 6)	7.9	11.5	17.3	13.2	21.3	36.0	38.1	37.8	41.3
Punësimi pritje (pyetja 7)	6.7	9.3	17.3	5.6	11.6	10.8	13.4	19.6	22.1
NDËRTIMI									
Aktiviteti ndërtues gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBN-së)	10.0	7.4	15.4	10.9	3.6	5.6	6.7	-1.5	1.4
Kontratat porositëse (pyetja 3, komponent i TBN-së)	-42.6	-41.1	-37.8	-33.0	-38.7	-33.1	-22.3	-36.4	-33.1
Punësimi pritje (pyetja 4)	7.9	14.4	15.2	12.4	10.9	7.8	10.0	6.7	15.5
Çmimet pritje (pyetja 5)	7.2	10.6	9.3	13.9	18.3	22.0	29.7	23.0	18.1
SHËRBIME									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBSH-së)	10.9	14.4	22.0	20.5	16.4	23.1	20.2	25.5	20.5
Kërkesa gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 2, komponent i TBSH-së)	7.9	12.4	21.8	23.5	19.3	22.2	25.7	29.0	25.6
Kërkesa pritje (pyetja 3)	40.3	34.4	38.1	36.9	22.9	12.6	30.2	36.7	31.6
Punësimi gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 4)	-4.6	1.5	18.9	14.1	5.8	9.2	11.2	18.2	-5.9
Punësimi pritje (pyetja 5)	13.3	13.7	17.1	20.7	9.2	0.5	12.5	6.7	13.2
Çmimet pritje (pyetja 6)	1.8	9.4	10.7	4.3	8.1	29.5	23.0	20.9	22.4
TREGTIA									
Ecuria e biznesit gjatë tre muajve të kaluar (pyetja 1, komponent i TBT-së)	19.0	19.7	32.0	9.7	11.4	9.8	10.0	11.3	20.7
Gjendja e inventarëve (pyetja 2)	-1.1	2.3	-1.2	-0.8	-0.1	0.8	0.5	0.3	-0.8
Pritje për porositë në të ardhmen (pyetja 3)	27.9	29.3	30.5	27.9	21.5	24.6	25.2	36.3	30.2
Ecuria e biznesit pritje (pyetja 4)	36.1	32.9	34.7	32.5	25.3	31.7	30.3	38.2	30.7
Pritje për ecurinë e punësimit	3.1	5.4	4.9	2.5	1.4	2.1	1.1	5.7	3.0

<i>(pyetja 5, komponent i TBT-së)</i>									
KONSUMATORI									
Situata financiare aktuale <i>(pyetja 1)</i>	-10.8	-11.9	-11.1	-10.4	-6.8	-13.3	-14.0	-12.3	-12.6
Situata financiare pritje <i>(pyetja 2, komponent i TBK-së)</i>	3.4	4.0	3.2	3.3	8.2	-3.8	-2.6	-1.0	-1.2
Situata ekonomike aktuale <i>(pyetja 3)</i>	-20.1	-19.5	-20.8	-19.0	-18.4	-22.8	-25.4	-23.9	-23.7
Situata ekonomike pritje <i>(pyetja 4, komponent i TBK-së)</i>	1.9	4.0	1.8	2.7	2.0	-10.5	-5.8	-4.7	-3.6
Çmimet aktuale <i>(pyetja 5)</i>	-4.7	-1.9	2.4	-1.8	0.6	27.1	30.6	28.8	24.9
Çmimet pritje <i>(pyetja 6)</i>	-16.4	-18.6	-11.5	-11.1	-7.7	8.2	-1.0	-3.9	-8.1
Papunësia pritje <i>(pyetja 7)</i>	8.5	7.1	9.0	9.9	7.3	12.6	10.6	11.4	8.7
Blerjet e mëdha aktuale <i>(pyetja 8, komponent i TBK-së)</i>	-63.0	-64.8	-63.3	-62.1	-62.8	-65.0	-66.4	-64.7	-68.7
Blerjet e mëdha pritje <i>(pyetja 9, komponent i TBK-së)</i>	-49.5	-49.5	-49.0	-48.4	-47.9	-50.9	-52.2	-49.2	-48.8
Kursimi aktual <i>(pyetja 10)</i>	-47.3	-46.2	-46.0	-41.9	-44.9	-48.6	-52.6	-47.5	-42.0
Kursimi pritje <i>(pyetja 11)</i>	-45.6	-44.6	-45.2	-40.5	-43.0	-48.7	-48.5	-45.7	-44.6
Situata e të ardhurave dhe shpenzimeve <i>(pyetja 12)</i>	2.6	2.4	2.2	5.0	3.5	-1.3	0.6	0.2	1.4

Burimi: Vrojtimi i Besimit të Biznesit dhe Vrojtimi i Besimit të Konsumatorit, Banka e Shqipërisë.

Aneks

Shpjegime metodologjike

Balanca është treguesi që përdoret më shpesh për agregimin e të dhënave cilësore nga vrojtimet. Ajo llogaritet si diferencë midis përqindjes së përgjigjeve pozitive dhe përqindjes së përgjigjeve negative. Balanca shprehet në pikë përqindje.

Treguesi i Besimit (TB) ndërtohet për çdo sektor dhe llogaritet si mesatare e thjeshtë e balancave të rregulluara sezonalisht të treguesve të cilët kanë korrelacionin më të lartë me serinë e referencës (serinë e të dhënave reale të ekonomisë).

Treguesi i Ndjesisë Ekonomike (TNE) ndërtohet duke u bazuar në të njëjtat balanca që përdoren për ndërtimin e TB-ve për secilin sektor (industri, ndërtim, shërbime, tregti dhe konsumatorë), duke synuar të kapë aktivitetin e ekonomisë në vend. Para agregimit të TNE-së, këto balanca standardizohen dhe peshohen.